



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1604/3 Prot.

Tiranë, më 27. 11. 2018

## **V E N D I M**

**Nr. 239, Datë 27. 11. 2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa Nr. 176, datë 14.11.2018, e F. A., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”, nga ana e Bashkisë Shijak.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **K O N S T A T O I :**

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se, prej vitit 1991 është banorë i fshatit Koxhas, të Bashkisë Shijak. Në vitin 2009 e në vijim, i është drejtuar Bashkisë Shijak për të përfituar pagesën e ndihmës ekonomike, por i është mohuar një gjë e tillë. Së fundmi, me anë të shkresës së protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës, me Nr. 1066/1 prot., datë 06.08.2018, i është drejtuar këtij institucioni për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Prefekti i Qarkut Durrës, pasi ka marrë informacionin nga ana e Bashkisë Shijak rreth problematikës së ngritur nga ankuesi, me shkresën Nr. 1066/3 prot., datë 24.09.2018, i ka përcjellë atij kthim përgjigjen e Bashkisë Shijak, ku ndër të tjera sqarohet se, familja e ankuesit përbëhet nga 2 anëtarë dhe janë banorë të fshatit Koxhas të Njësisë Administrative Xhafzotaj. Për shkak të gjendjes ekonomike të rënduar të kësaj familje, Bashkia Shijak ka trajtuar deri në

muajin Maj 2018, me pagesë të ndihmës ekonomike në masën 3000 lekë. Në kushtet kur ankuesi nuk jeton në banesën që disponon në territorin e kësaj njësie administrative, por në një banesë e cila ndodhet në Shkozet të Bashkisë së Durrësit, atëherë i është hequr e drejta e përfitimit të ndihmës ekonomike. Sipas Bashkisë Shijak, nëse ankuesi do të kërkojë të përfitojë ndihmë ekonomike në banesën ku jeton aktualisht, duhet të zhvendosë lejen e banimit në Bashkinë Durrës dhe të kërkojë të përfitojë atje pagesën e ndihmës ekonomike, pasi referuar VKM-së Nr. 955, datë 07.12.2016, nuk mund të përfitojë ndihmë ekonomike nëse nuk banon në territorin e Bashkisë Shijak.

Në ankesën e bërë, F. A. kërkoj të përfitojë pagesën e ndihmës ekonomike nga ana e Bashkisë Shijak.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur prova, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Në kushtet kur ankuesi, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi asnjë informacion apo argument rreth shkakut të bindjeve politike, atëherë me

shkresën Nr. 1604/1 prot., datë 15.11.2018, iu kërkua të parashtrojë me shkrim dhe të dërgojë prova dhe fakte mbi lidhur me bindjet politike, kohën kur ka përfituar ndihmë ekonomike dhe vendbanimin e tij.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, F. A., me shkresën<sup>1</sup> datë 18.11.2018, informoi Komisionerin se, nga ana e Bashkisë Shijak nuk ka përfituar ndihmë ekonomike edhe në kohën që ky institucion është drejtuar nga përfaqësues të subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë, por edhe aktualisht që drejtohet nga përfaqësues të subjektit politik Partia Socialiste. Gjithashtu në këtë shkresë ankuesi, nuk vuri në dispozicion asnjë informacion, provë apo argumenta rreth bindjeve të tij politike. Në përfundim ankuesi sqaroi se, banon në Shkozet të Bashkisë së Durrësit.

Në kushtet që ankuesi nuk ka vënë në dispozicion prova dhe fakte me anë të të cilave të argumentojë shkakun e pretenduar në ankesë, si dhe referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ku citohet se “Ankesa nuk pranohet nëse nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe bazuar në nenin 33, pika 4/dh e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së F. A., për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

---

<sup>1</sup> Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 1604/2 prot., datë 20.11.2018